URDHËR
Nr. 65, datë 4.2.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore", të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për nënshkrimin e autorizimeve për dërgim me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Kulturës jashtë qendrës së punës, brenda vendit, drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Agron Gaxho.
2. Kompetenca e deleguar do të ushtrohet nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Agron Gaxho, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.
3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.
4. Ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Agron Gaxho, si dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Kulturës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti